



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt. 27.11.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi, (IQO), Nazlije Shala, (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Biljana Spasic (SL), dhe Ratomir Ristic (SL)

Të pranishmit tjerë: Përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve Obiliq (2026 – 2029)
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 19 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve Obiliq (2026 – 2029).

Enver Gashi – Ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e rekomanduam që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë në Kuvend dhe të aprovohet. Ne si grup nuk kemi ndonjë vërejtje dhe nëse, dikush ka mund të japë kontributin e vet.

Sami Ahmeti – Edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, e thamë që ky plan i ka kaluar të gjitha hapat për të cilët jemi dakord që ta votojmë si plan, kështu që ne do të votojmë pro.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për morën Vendim për Aprovimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve Obiliq (2026 – 2029).

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MFPT lidhur me vendimin nr.01-104-02-29663-25, të dt.29.09.2025 për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e Shërbimit Civil të Administratës të Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për morën Vendim për Shfuqizimin e vendimit nr.01-104-02-29663-25, të dt.29.09.2025 për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e Shërbimit Civil të Administratës të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesja - Paraqiti kërkesën nga MFPT lidhur me vendimin nr.01-060-01-33374-25, të dt.24.10.2025 për ndarjen emjeteve financiare për pagesën e shujtave për punëtorët shëndetësor të Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për morën Vendim për Shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-33374-25, të dt.24.10.2025 për ndarjen emjeteve financiare për pagesën e shujtave për punëtorët shëndetësor të Komunës së Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja - Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, më lejoni të ju falenderoj për 4 vite bashkëpunim dhe na priftë e mbara në përditshmëritë tona dhe suksese asambleistëve të ardhshëm.

Mbledhja përfundoi në ora 11:18'

Zyrtarë e lartë për punë të KK

Azize Zeneli

